

## JUP KASTRATI

## VEPRAT GJUHËSORE TË JERONIM DE RADËS

Gjatë viteve 1836—1899, d.m.th. mbrenda gjashtëdhjetepesë vjetësh; krahas krijimtarisë letrare, folklorike dhe hartimit të teksteve shkollore; Jeronim de Rada u muer edhe me gjuhësi, përpiloi një seri punimesh gjuhësore rreth shqipes, shkrua në italisht dhe botue në organe të ndryshme të kohës ose në libra të posaçëm.

Nën këtë titull na nënkuptojmë shkrimet e tij me karakter filologjik; veprat gramatikore, fjalorin e rapsodivet, konferencat e tij mbi lashtësinë e shqipes dhe të popullit tonë si edhe punën e madhe që bani për alfabetin e gjuhës shqipe.

Me përjashtim të studimit të Michele Marchiaò-it, botue më 1902<sup>1)</sup> dhe, tash së voni, të një artikulli të Emanuele Giordano-s<sup>2)</sup>, deri më sot nuk është shkruar ndonjë punim i veçantë mbi veprat gjuhësore të De Radës. Kumbësia jonë është një sprovë e parë në shqipet në këtë drejtim, lidhë me një kapitull të randësishëm të krijimtarisë së atdhetarit të shquem arbëresh.

Në "Autobiografinë" e vet, De Rada na tregon se në vitin 1840 botoi në fletoren "Lucifero" të Napolit "Hyjnitë pellazgjike". Aty ai na njofton se këtë artikull vazhdoi me e rishtypë edhe ndër botime të tjera. Qëllimi i tij ishte që, politeizmin grek, ta shpjegonte me anë të gjuhës sonë. "Profesor Dorotea i Universitetit të Napolit që i pari që e pranoi e ma ngarkoi mue këtë zbulim të identitetit të pellazgëvet me shqiptarët; zbulim, i cili që pranue ma vonë prej shkencës europiane". Kështu shkruente De Rada në mbarim të jetës së vet, katër vjet para se të vdiste, pikërisht më 1899<sup>3)</sup>.

Kurse, pesëmbëdhjetë vjet na përpara, më 1885, në një shenim të vetin të artikullit "Pellazgë dhe Helenë", botue në "Fiàmuri Arbërit", auktori u shprehte kështu: "Më 1843, botova në "Lucifero" e, mandej, në një shenim të "Passeggiate intorno Napoli" të Emanuele Bidëra-s ato që m'u dukën hyjni të një së kaluemeje prehistorike, të cilat, bashkatdhetari im Tommaso Pace prej Shën Kostantinos, i ribotoi në Athinë në "Minerva", në tetorin e 1845. Mbas 1850 Europa muji me i konsiderue të ilustrueme dhe të shpjegueme prej Hahn-it"<sup>4)</sup>.

Përsëri De Rada, në një vend tjetër, dhe pikërisht në hymje të veprës së tij "Lashtësia e kombit shqiptar", botue më 1864, na mëson se, kur gjindej në Napoli, më 1843, nësa po lexonte Herodotin, i lindi ideja me shkrua artikullin "Identitete të shqiptarëve me pellazgë", të cilin punim e botoi në "Passeggiate intorno Napoli" të Emanuele Bidëra-s<sup>5)</sup>.

1) Michele Marchiano, *L'Albania e l'opera di Girolamo de Rada*, Trani, 1902: "Scritti filologici" (fq. 247-279), "Scritti grammaticali" (fq. 280-299).

2) Emanuele Giordano, *Il lessico di Girolamo de Rada*, në "Rassegna di studi albanesi", nr. 2, 1963, fq. 37-41. (Atti del 3<sup>o</sup> Convegno di Studi Albanesi, Cosenza).

3) Girolamo de Rada, *Autobiologia*, II, 11, Napoli, 1899.

4) Girolamo de Rada, *Pelazgi ed Elleni*, në "Fiàmuri Arbërit", viti II, nr. 5, fq. 5; Cosenza, 20. IX. 1885.

5) Girolamo de Rada, *Antichità della nazione albanese e sua affinità con gli Elleni e i Latini*, Napoli, 1864, fq. 1, 2.

Këto tri informata, që na jep vetë De Rada, janë interesante për fillimin e veprimtarisë së tij gjuhësore dhe shkencore; por ato kanë një kontradiktë përsa i takon datës ekzakte. Në njezin burim shenohet viti 1840, ndërsa në dy të tjerat 1843.

Po në lidhje me "Hyjnitë pellazgjike" kemi edhe disa të dhana të tjera: Marchianò e Petrotta<sup>1)</sup> pranojnë vitin 1840 si botim të parë; kurse Bugliari<sup>2)</sup> shenon vitin 1841. Simbas Marchianò-it, më 1842, De Rada e ribotoi këtë punim, tue e shtypë në "Mattneer" të Bidëra-s dhe, më 1844 ose 1845, në "Passeggiate pelagiche" po të Bidëra-s; ndërsa Bugliari shenon se u riprodhë nga Bidëra në "Passeggiate intorno Napoli", por pa u shqiptue për vitin e rishtypjes. Kohët e fundit, Dh. S. Shuteriqi ka shprehë mendimin se "në njërin nga këto dy vite, 1844 ose 1845, De Rada ribotoi shkrimin ("Divinazioni pelagiche" ose "Divinazioni pelagiche" — J.K.), ndofta të përpunuar në një vepër të mikut të tij, G. E. Bidëra: "Quaranta secoli" ose "Passeggiate pelagiche", 1845"<sup>3)</sup>. Bugliari shenon se ky ribotim u ba më 1844. Tue u mbështetë tek ky i fundit, edhe Manek-Pekmezi-Stotz<sup>4)</sup> ripohojnë vitin 1844; ndërsa Petrotta thotë se u ribotue më 1845.

Sidoqë të jetë, duhet të pranojmë se, në bazë të të dhanave të masipërme, "Hyjnitë pellazgjike" u botuen dhe u ribotuen mbrenda viteve 1840-1845. Me saktësi ende sot nuk mund të thuhet, mbassi, me sa duket, asnjëni s'e ka pa këtë punim të De Radës, as ata që e njoftën për së afërmi poetin e madh, si Bugliari, Marchianò, as studjuesit e mavonshëm arbëreshë si Gualtieri<sup>5)</sup> e Petrotta, që u muerën me veprimtarinë letrare të poetit tanë<sup>6)</sup>.

Ç'e shtyni De Radën me e shkruar këtë vepër? Cilat qenë gurrat, ku ai u mbështet për ta hartue atë? Ç'përbante ai shkrim i tij, që pati aq jehonë? Këto janë disa nga çështjet që studjuesit të sotëm i dalin përpara gjatë shqyrtimit të krijimit të parë gjuhësor të arbëreshit të shquem.

Në atë punim De Rada ortavej me provue se emnat e disa hyjnive greke, që në greqishtet, me mjetet e saj të mbrendëshme, ishin të pashpjegueshme, mund të sqaroheshin, simbas tij, me anë të gjuhës sonë. Ai përpigje, gjithashtu, me shpjegue, ndonëse pa baza të mjaftueshme shkencore, se një varg emnash të mitologjisë greke, në të vërtetë ishin shqip, sepse interpretoheshin gjoja, me anë të shqipes së sotme. Aty ai hidhte idenë se pellazgët i kishin dhanë hua kulturës së lashtë greke një varg elementesh<sup>7)</sup>. Me këtë ai donte me thanë se gjuha shqipe asht ma e moqme se greqishtja e vjetër. Nga ana tjetër, tue mprojtë tezën se shqiptarët janë pasardhësit e pellazgëvet, ai kishte për qëllim me i qitë të parët tanë ma të lashtë se grekët.

Dija e sotme ka provue se një tezë e tillë, në themel, nuk ka vërtetësi; por, pamvarësisht nga kjo, artikulli i poetit tanë pati përfundime të mira nga ana atdhetare. Këto mendime të De Radës, në lidhje me teorinë pellazgjike, u përfaqen nga atdhetarët shqiptarë dhe u përdorën në luftën që báj-

1) Gaetano Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931, fq. 480.

2) G.C. Bugliari, *Saggio sulla vita e sulle opere di Girolamo de Rada*, në "La Nazione Albanese", viti II, nr. 7, fq. 6, Pallagorio (Catanzaro), 15. IV. 1898.

3) Dhimitër S. Shuteriqi, *Bibliografi e letërsisë së vjetër shqipe*, në "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore", viti XVII, nr. 1, fq. 136, Tiranë, 1963.

4) F. Manek — G. Pekmezi — A. Stotz, *Albanesische Bibliographie*, Wien, 1909, fq. 27.

5) Vittorio G. Gualtieri, *Girolamo de Rada*, Palermo, 1930, fq. 15-36.

6) Jup Kastrioti, *Jeronim de Rada* (Jeta dhe veprat), N. SH. B. "N. Frashëri", Tiranë, 1962, fq. 8, 10. — Jup Kastrioti, *Odiseu — I dbeumi i Krutës*, në rev. "Arësimi Popullor", viti XIX, nr. 1, fq. 128-133, Tiranë, janar—shkurt 1963.

7) Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Historia e Shqipërisë (1839-1912)*, maket për diskutim, Tiranë, shkurt, 1964, fq. 11, (dispensë).

shin ata kundër orvatjeve të shovinistëve grekë për të asimilue kombësinë shqiptare. Artikulli, i ribotuem, pati jehonë në shtypin e Athinës dhe shqiptarët e Rumanisë u treguen entuziastë për tezat e tij. Ndër ta, sigurisht ka qenë edhe Veqilharxhi, i cili ia përmend emnin poetit arbëresh, në letrën e famëshme që i dërgon të nipit, Jani Calit, më 7.IV.1846<sup>1)</sup> Që atëhere fillon interesi i madh i rilindasvet tanë për të provue prejardhjen pellazgjike të popullit shqiptar. Në këtë mënyrë, shkrimtarët tanë të shekullit të nandëmbëdhëtë e banë të vetën këtë tezë dhe e propaganduen ndër veprat e tyre, si b.fj. Jubani, Pashko Vasa, Naimi, Samiu, etj.

Po, çka asht ma e randësishme për kohën, teza pellazgjike u ba objekt studimi edhe për dijetarë të huej, të cilët, në një mënyrë a në një tjetër, u shprehën mbi këtë çështje. Mbas De Radës, gjatë qindvjetit të kaluem, mendime të ngjashme, në lidhje me prejardhjen pellazgjike të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar, çfaqën edhe një varg studjuesish dhe albanologësh të tjerë. Le të përmendim këtu, në rend kronologjik: Bidëra<sup>2)</sup>, Hahn<sup>3)</sup>, Biondelli<sup>4)</sup>, Ascoli<sup>5)</sup>, Camarda<sup>6)</sup> dhe ndonjë studjues tjetër, si Canini<sup>7)</sup>.

Por edhe përpara De Radës, teza pellazgjike nuk ishte e panjoftun. Kështu, në tridhjetë vitet e para të shek. XIX, disa dijetarë arbëreshë dhe të huej u përpogën me provue vjetërsinë e popullit shqiptar përmes gjuhës shqipe, si p.sh. Angelo Masci, më 1807, në "Fjalim mbi prejardhjen, doket dhe gjendjen e tashme të kombit shqiptar"<sup>8)</sup>, Malte-Brun, më 1828, në "Gjeografinë e përgjithëshme"<sup>9)</sup>, Giuseppe Crispi, më 1831 dhe 1836, në veprën e tij "Mbi gjuhën shqipe"<sup>10)</sup>, Giovanni Schirò, më 1834, në studimin e tij "Lidhje midis Epirit dhe mbretnisë së dy Sicileve. Kujtime"<sup>11)</sup> etj. Padyshim që, punimet e arbëreshëve të lartëpërmendun dhe të gjeografit të njoftun Malte-Brun, De Rada do t'i ketë njoftë dhe do të jetë ndikue, sado pak, prej tyre. Le të shënojmë këtu se, për Angelo Masci-n, ai pat një nderim të veçantë; herë mbas here, në veprat e mavonëshme gjuhësore, do ta përmendë emnin e tij.

Të përpunuem, siç do ta shofim edhe ma poshtë, Jeronim de Rada e ribotoi edhe dy herë të tjera këtë shkrim të tij, që e hodhi në mënyrë shumë të gjallë në veprimtarinë tonë atdhetare dhe që e lidhi edhe me rilindasit e Shqipnisë.

Më 1864, De Rada botoi në Napoli veprën italisht "Lashtësia e kombit shqiptar dhe afërsia e tij me helenët dhe latinët"<sup>12)</sup> Ky libër ishte një përpunim

1) Gazeta Shqipëria e Re", Konstancë, 29. VII.1923.

2) E. Bidëra, *Quaranta secoli*. Racconti sulle due Sicilie del Pelasgo Matneer, vol. IV, Napoli 1846.

3) J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena — Wien, 1853-54, I, fq. 214, 215, 221, 254.

4) B. Biondelli, *Studi linguistici* Milano 1856. Letteratura popolare dell' Epiro.

5) G. Ascoli, *Studi Critici*, Roma, 1877, Saggi ed appunti.

6) D. Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864, fq. 103.

7) M. A. Canini, *Lettere al giornale "L'Adriatico" sulla questione balcanica*. Venezia, 1886.

8) Angelo Masci, *Disorso sull'origine, costumi e stato attuale della nazione albanese* 1807, fq. 88.

9) Malte-Brun, *Geografia Universale*, Milano, 1828, vol. VI, fq. 243.

10) Giuseppe Crispi, *Memoria sulla lingua albanese* di cui se ne dimostra l'indole primordiale e se ne rintraccia la rimota antichità sino ai Pelasghi, ai Frigi, ai macedoni e agli Eoli primitivi, che la costituisce in gran parte madre della lingua greca, Palermo, Lorenzo Mato, 1831, fq. 74.

11) Giovanni Schirò, *Raporti tra l'Epiro e il regno delle due Sicilie.-Memorie*, Palermo, 1834, fq. 158.

12) Girolamo de Rada, *Antichità della nazione albanese e sua affinità, con gli Elleni e i Latini*, Napoli, 1864, Stamperia dell'Industria, Largo S. Marcellino, 2 in 8<sup>o</sup>, me 40 faqe.

i "Hyjnive pellazgjike" dhe përban bazën e kërkimeve të tij gjuhësore. Vepra ka një hymje të shkurtë, tre kapituj të ndamë sejcili në paragrafe dhe disa shenime sqaruese. Në hymje, auktori thekson se, me kërkimet mbi kombim shqiptar, tashti po merren profesorë të shquem në shkencat gjuhësore. "Dëshëroj — shton ai — me qitë në dritë disa mendime të shprehuna në librin e pestë të "Konsideratave" të mia<sup>1)</sup>.

Që prej sa vitesh, hartuesit të veprës i kishin tërheqë vemendjen do emna të mitologjisë së vjetër greke. Me anë të këtyne ai mendon të ndriçojë prejardhjen e shqiptarëve. Ai gjen gjurma të ligjërimeve shqipe ndër mitet e vjetra fetare helene. Qëkurse pat qenë nxanës i shkollës së mesme, ai pat ndeshë ndër kangët e Homerit dy fjalë, që nuk ishin greke: *Iperborei* dhe *Emathia*, të cilat i shpjegon dhe i interpreton me anë të fjalëve shqipe, përkatësisht: *borë* dhe *e madhe*. Gjatë jetës shkollore, tue lexue klasikët e Greqisë, ai gjet edhe fjalë të tjera të afërta me gjuhën tonë, të cilat ia përforcuen bindjen se, në mes të helenëve dhe të epirotëve, ka mjaft përgjasime. Ai kishte takue te Herodoti se pellazgët shtriheshin në veri të Greqisë. Mbassi flet për politeizmin helen, De Rada përpiqet me shpjegue, me anë të gjuhës shqipe, emnat e hyjnive greke: *Adhé, Afrodite, Atrekia, Athena, Demeter, Dielio, Erebo, Hera, Ifestos, Jea, Nemesi, Oceano, Teti, Uranos, Zeus*, si edhe emnat e dy personazhevet homerikë: *Akileu* dhe *Ulisi*.

Ka mundësi, ndoshta, që në ndonjenën ndër këto fjalë, intuita e auktorit t'i afrohet së vërtetës; por, në këtë mes, sot për sot, vetëm mendimi i etimologut tonë të shquem, Profesor Eqrem Çabejt, do të peshonte.

Gjurmë të shqipes De Rada gjen edhe ndër disa hyjni të Romës, si p.sh. tek *Anna Perenna, Diana, Elicio, Lucina*.

I nisun nga këto shenje, poeti i madh arbëresh mendon se të parët e shqiptarëve u dukën në tokën greke përpara se të vijshin aty helenët.

Mandej qet në pah afërsinë në mes të shqiptarëve dhe të maqedonëve të vjetër sidhe veçoritë që i bashkojshin këta me fiset helenike dhe italike. Në ravën e gjurmimeve të tij, arbëreshi ynë i shquem përmend edhe këto qytete: *Pella, Dyrachium, Cremia, Krimea, Farsalia, dhe Tempe*, të cilat orvatet, por pa sukses, t'i interpretojë me anë të shqipes.

Simbas tij, pika ma dalluese asht ndërtimi i mbrendshëm i gjuhës shqipe. Ky ndërtim çfaqet, kryesisht, në lakim të përemraves dhe në zgjedhim të foljevet.

Në fillim të kapitullit të dytë, De Rada, mbassi thekson se shqiptarët lulëzuen përpara grekëve dhe latinëve, shpreh edhe disa mendime rreth apelativëve *arbëresh* dhe *shqiptar*, të cilat kanë kalue pa u vu ré, deri më sot nga studjuesit tanë, që janë marrë me hipotezat e prejardhjes së këtyne emnave. Po aty, ai interpreton edhe fjalët: *ksheti* (=gersheti), *Pirro* dhe *Aleksandër*. Mandej zgjedhon foljen *me dashë* në kohën e pakryeme të mënyrës dëftore, tue e krahasue me latinishten dhe me italishten; po kështu edhe kohën e kryeme të thjeshtë të kësaj mënyre si edhe mënyrën urdhënore. Auktori mundohet me gjetë afërsi në mes të së pakryemes dhe të së kryemes së thjeshtë të mënyrës dëftore të gjuhës shqipe me ato të latinishtes dhe të italishtes. Disa vite ma vonë edhe Gustav Meyer-i do të bijë në një interpretim të tillë të gabueshëm, tue e afrue të kryemen e thjeshtë të shqipes të tipit *-va* me të pakryemen e italishtes në *-avo* dhe me të pakryemen e latinishtes *-abam*. U desh të vinte Holger Pedersen-i që ta hidhte poshtë këtë mendim, që ishte në kundërshtim me ligjet fonetike të shqipes.

13) Kjo vepër mbeti dorëshkrim. Nuk dimë se ç'përbante.

Ma poshtë De Rada lakon përemnat vetorë *unë* dhe *ti* siedhe pronorët *imi*, *jotja*, *yni*, *jona*, tue u përpjekë me gjetë afërsi me greqishten e vjetër dhe me latinishten. Në paradigmen që sjell, duket ndikimi i Hahn-it.

Mbassi ka vendosë këto ekuacione dhe premisën që gjuha shqipe, në zhvillimin e saj, ka qenë përpara greqishtes dhe latinishtes, De Rada nuk gjen popull tjetër që ta ketë folë këtë gjuhë, përveç pellazgëvet. Prandaj si rrjedhim, simbas tij, shqipja asht gjuhë pellazgjike. Në këtë përfundim auktori arrin edhe me faktin se, gjoja, shqipja asht e thjeshtë në lakim dhe në zgjedhim, veçori që nuk u gjindka në gjuhët klasike.

Në vitin 1871, Zef de Rada, djali i poetit të shquem arbëresh, botoi në Firenze veprën italisht "*Gramatikë e gjuhës shqipe*"<sup>1)</sup>. Libri ka një randësi të posaçme për faktin se asht gramatika ma e parë, relativisht, e plotë për kohën, e hartueme nga një shqiptar. Vërejtjet gramatikore rreth gjuhës sonë siedhe gramikatit e shqipes, që u hartuen a u botuen deri më atë vit, kryesisht qenë përpilue nga të huejt. Kështuqë, merita kryesore në hartimin e një gramatike shqipe, ndër shqiptarët, i takon Zef de Radës. Por, fatkeqësisht, edhe kjo e shkrueme në gjuhë të huej. Duhet pritë deri tek Sami Frashëri, më 1886, që të dalë gramatika e shqipes në gjuhën amtare.

Vepra, teksa u botue, u mbarue së shitiuni. Po De Rada pati kujdes që t'ua dërgonte njerëzve që interesoheshin për gjuhën shqipe siedhe dijetarëve që merreshin me problemet e gjuhësisë indoeuropiane. Një gjà të tillë e faktojnë letrat e shumta, që i janë dërgue herë mbas here auktorit, që në vitet e para të botimit. Këto letra, siç dihet, ruhen sot në Arkivin e Shtetit. Në mes të emnavet të shumtë, që interesohen për këtë gramatikë, figurojnë edhe ata të dijetarëve të përmendun të kohës: Schuchardt, Dora d'Istria, Theophil Stier, Max Müller, Bréal, Brockhaus, Dhimitër Camarda, Vinçenc Dorsa, Pjetër Kjara, Sami Frashëri, Miklosich, Gustav Meyer siedhe të shkrimtarit Domenico Mauro dhe të intelektualëve Prestner, Jul Oppert, etj. Gramatika u njoft dhe u çmue shpejt në mbarë Europën, që interesohet për gjuhën, vendin dhe popullin tonë.

Tue marrë parasysh se Zefi qe 17-18 vjeç, kur hartoi këtë vepër, në kohën kur ishte nxanës gjimnazi në Kolegjin e Koriliano Kalabros, në periudhën 1869-1870, na kemi shprehë mendimin, që përpara dhetë vjetësh<sup>2)</sup>, se kjo vepër, në të vërtetë, nuk asht e Zef de Radës, por e të jatit të tij, Jeronim de Radës. Poeti ynë i madh, tue pa në të birin një talent të rrallë dhe një shpresë të mirë për të ardhmen, ia fali veprën e vet djalit të tij, me qëllim që ta nixte kahë puna shkencore. Që kjo "*Gramatikë*" asht e Jeronimit provohet edhe nga një listë në dorëshkrim, që ky i pat dhanë Marchianò-it.

Gramatika çelet me një kushtim princeshës Elena Gjika, në të cilin theksohet se mjeti ma i mirë për t'u bashkue dhe afrue njeni me tjetrin asht gjuha. Por kjo, vazhdon auktori, asht vorfënueme nga fatkeqësitë tona dhe asht përzie me fjalë dhe trajta të hueja. Prandaj u ndie nevoja me zbulue rregullat e repta, prej kahë, ndonëse në mes larmish dialektore, ruhet kjo gjuhë shumë fisnike.

Në faqen tjetër asht shenue bibliografia e përdorun, prej nga janë nxjerrë shembujt përkatës për të konkretizue rregullat, që përmban "*Gramatika*". Në këtë listë librash së çfrytëzuem përmenden veprat e Jul Varibobës, Stefan Baffa-s, Grigor Gjirokastirit, Anton Santorit, Kosta Belushit Guarda-

1) Giuseppe de Rada, *Grammatica della lingua albanese*, prima parte, Firenze 1870; (1871), Tipografia dell'Associazione, Via Vallonda, nr. 79, fq. 95x2 dim. cm. 15,5x23,5

2) Jup Kastrioti, *Zef de Rada dhe gramatika e tij*, në "*Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore*", viti XIII, nr. 1, fq. 95-111. Tiranë, 1959

boskit, Dhimitër Camarda-s, Hahn-it, Reinhold-it, Vinçene Dorsa-s, Konstandin Kristoforidhit dhe Jeronim de Radës. Nga gjithë kjo pasqyrë burimesh, shifet qartë përpjekja e madhe, që ka bërë auktori për përpilimin e "Gramatikës". Kjo të bën me besue edhe një herë për punën serioze dhe sistematike të tij. Të bie në sy se nuk asht vjelë material vetëm nga letërsia artistike dhe fetare, por edhe nga poezia popullore.

Fill mbas kësaj bibliografie, kemi parathanien e veprës. Që në fillim auktori shenon: "Kjo gramatikë e gjuhës sonë, që unë po provoj me e përshkruar, nën drejtimin e atit tim, asht një përmbledhje besnike dhe e thjeshtë e ligjëve të saj, që ndihen në të folmet popullore të kolonive arbëreshë, në të cilat unë jam lindë". Mandej ai shenon tri veçori të dialektit të tij, që e kanë marrë për bazë, në librin e vet, këtë të folme të arbëreshëve. Simbas auktorit, dialekti arbëresh i ka të gjitha cilësitë për t'u vu në bazën e gjuhës sonë kombëtare, për arsye se asht e folmja e shqiptarëve që emigruen në Itali, se përmbledh në gjiun e vet të gjitha larmitë dialektore të shqipes, që u bartën me mërguesit e ndryshëm dhe, së fundi, ruen ma mirë se të folmet tjera, shenjat dalluese të një kulture së moçme.

Kundër kësaj ideje, u pat shprehë, me plot të drejtë, Pjetër Kjara, i i cili ishte jurist dhe njeri me kulturë të gjanë klasike. Në letrën që i drejtoi ky dijetar i shquem De Radës, me datën 1 maj 1870, nga Palermo, jo vetëm që recenson gramatikën e Zefit, të cilin e quen "... vepër me të vertetë kombëtare", por njëkohësisht mban qëndrim kritik edhe ndaj pikëpamjes së auktorit për dialektin bazë të gjuhës letrare kombëtare shqipe. Ai shprehet me plot gojë kundër mendimit të gabuem të De Radës për të marrë si bazë të gjuhës së njëzeme dialektin arbëresh, pse ai e di se, me gjithë të mirat e veta që ka; ky dialekt nuk mund të ngjallte ndër shqiptarët, toskë e gegë, ndërgjegjen kombëtare për t'u bashkuar, për të vetmën arsye se nuk njihet nga shqiptarët "Na — thekson Pjetër Kjara — nuk shkruem vetëm për arbëreshët e Italisë: përpjekjet tona duhen mbledhë dhe drejtue kahë Atdheu ynë i vërtetë (kahë Shqipnia — J.K.), ku duket se ka hy ndikimi i kohëve". "Në të vërtetë — vazhdon Kjara — veprat shqipe do të kenë përmbi tre milion lexues, kështu, botimet tona do të jehojnë mbi brigjet e liqenit të Shkodrës, kurse kangët e mirëditasvet dhe të toskëve do të këndohen dhe të çmohen përgjithësisht ndër kolonitë tona". Po aty ai kritikon edhe Dhimitër Camardën, që "ka dashë me krijue një gjuhë shqipe të pakuptueshme jo vetëm për banorët e Shqipnisë, por edhe për në që jemi në përpjekje të vazhdueshme me gjuhën që flitet ndër kolonitë tona arbëreshë. Ai ka dashë me krijue një farë gjuhe shqipe ditunie, që nuk gjindet e shkrueme në kurrnjë libër, që tradhëton gjuhën, e cila ec për të mirën e popullit". Në fund ai çmon shumë veprat e Kristoforidhit dhe sugjeron që ato të merren si model.

Mbas alfabetit, që asht latin por me pesë shkronja greke, auktori mirret me zanoret dhe diftongjet. Në klasifikimin e bashkëtingëlloreve ai dallon buzoret, grykoret, dhamboret, ndër dhamboret, të langëtat dhe fishkullueset. Mandej studjon theksin. Që në fillim ai shkruen: "Theksat e gjuhës greqishte nuk janë mjete të mjaftueshme për të shenue ndryshimet e intonacionit, që jep në shqipet e njëjta zanore"; megjithatë — shton De Rada "na muerëm theksat e greqishtes si shenja të thjeshtë të tingujve të sasive ma të preme: të randë (r), të mprehtë (') dhe cirkonfleks (^)". Ja disa shembuj nga faqja 9: *mool* (=mollë), *môla* (=molla), *vógchelh* (=i vogël), *bòtt* (=deltinë), etj

Këtu duhet të vëmë në dukje, se për të parën herë në historinë e gramatikave të gjuhës shqipe, u zbatue metoda statistikore në analizën praktike të tingujvet. Se në çfarë përpjestimesh qëndrojnë zanoret ndaj bashkëtingë-

llorëvet dhe anasjelltas, auktori këtë na e shpreh me shifra në një pasqyrë krahasuese, zbatue mbi shtatë faqe shqip.

Morfologjisë i ka kushtue tetëdhjetëdy faqe (10-92). Tek emni përmend dy trajta: të shquemen dhe të pashquemen, të cilën — thotë ai — "nuk e kanë as helenët, as latinët". Kategorizimin e emnavet të pashquem e ban simbas mbaresave të ndryshme, veç për mashkulloren dhe veç për femnoren. Emnat i rendit simbas tri gjinish. Në shqipet një shtatë rasa. Tue marrë për bazë gjindoren, emnat i klasifikon në tri lakime: në të parin me *-u*, në të dytin me *-i* dhe në të tretin me *-ri*. Në kapituj të veçantë vëzhgohen nyjet, mbiemnat dhe përemnat. Janë për t'u shënue, sidomos, paragrafet rreth emnave zvogëlues, përkëdhelës dhe smadhues siedhe rreth shkallëve të mbiemnavet cilësorë. Kapitulli që ze vendin ma të madh në "Gramatikë" asht ai i foljevet, të cilit De Rada i ka kushtue plot tridhjetë faqe (fq. 58-88). Aty dallon veproren, pësoren dhe mesoren. Mënyrat janë katër: dëftorja, urdhërorja, lidhorja dhe dëshërora. Numrat dy: njëjës dhe shumës. Tregon format e paskajores, pjesores, përcjellores, supinit siedhe të emnavet foljorë dhe të mbiemnavet foljorë. Përmend tri kohët e thjeshta: të tashmen, të pakryemen dhe të kryemen e thjeshtë. Kallëzon se ndonjë herë e tashmja përdoret për të ardhmen absolute (futuri absolut). Kohët e përbame të dëftores janë pesë. Foljet i klasifikon në pesë zgjedhime, tue u mbështetë në ndryshimet që pëson zanorja e temës foljore gjatë zgjedhimit. Pjesëve të pandërrueshme të ligjëratës u ka kushtue katër faqe (88-92). Në fund të veprës ka disa mendime të aukturit mbi gramatikën shqipe në veçanësi dhe mbi gjuhën në përgjithësi.

"Gramatika" asht si një traktat i shkurtër gramatologjie. Shpesh libri merr pamjen e një vepre shkencore, me ato shenime dhe vërejtje pothuajse për çdo faqe. Ndonjëherë auktori polemizon me ndonjë gjuhëtar. Krahasimi i disa trajtave, fjalëve dhe skajeve me gjuhët greke, latine, italiane ia përforon edhe ma tepër fizionominë shkencore veprës. Punimi ka mjaft gjana me vlerë edhe për dialektologjinë, me vërejtje rreth së folmesh ndryshme të dialektit arbëresh. Ky punim mund të çfrytëzohet me mjaft dobi edhe në sintaksë, veçanërisht përsa i takon përdorimit të rasavet. Në lidhje me vendoren, De Rada thekson se trajta me *-t* i pat rrëshqitë edhe dijetarit Camarda. "Në të vërtetë — shton ai — kjo rasë nuk qe njoftë as prej P. da Lecce-s" (fq. 24). Kjo të ban me mendue se nuk janë shenue në bibliografi të gjitha veprat e konsultueme dhe të çfrytëzueme.

Gjatë pjesës së dytë të shek. XIX, Jeronim de Rada dha një kontribut të vlefshëm në zhvillimin e gjuhës shqipe. Njëqoftëse Argon-dizza, Cremonese, Camodeca, Bilotta e të tjerë filluen të mbledhin dhe të botojnë material nga leksiku i dialektit arbëresh, kjo, në radhë të parë, i detyrohet De Radës.

Më 10 prill 1885, në shtojcën e së përkohëshmes "Fiàmuri Arbërit", quhej "Biblioteka Kombëtare", filloi me u shtypë "Fjalori i Rapsodivet"<sup>1)</sup> nga Jeronim de Rada. Në parathanie të kësaj vepre gjuhësore auktori nënvizon se qëllimi i tij, së pari, ka qenë me interpretue fjalët që gjinden në përmbledhjen e kangëve popullore që botoi ai, dhe, së dyti, me bā të njoftun disa forma të vjetra të gjuhës shqipe, që ruhen ndër kolonitë arbëreshe. Ai ia kishte besue nipit të vet, Michele de Rada, hartimin e fjalorit; njëkohësisht e kishte udhëzue atë që me i krahasue fjalët shqipe me greqishten. Po Mikeli vdiq i ri, në moshën njëzetvjeçare. Veprën e nisun prej tij e vazhdoi djali

1) Girolamo de Rada, *Lexicon delle Rapsodie* në "Fiàmuri Arbërit" (La Bandiera dell'Albania), Corigliano Calabro, viti II, nr. 1, fq. 97 "Biblioteca Nazionale" deri tek viti II, nr. 3, fq. 118, dt. 10-IV-20-II-1885.

i poetit të madh arbëresh, Giuseppe de Rada, deri tek shkronja *n*. Por, siç dihet, mbas shtatë muejsh pune mbi këtë fjalorth, edhe Zefi u shue në lulen e rinisë. Kështuqë këtë ndërmarrje e vazhdoi dhe e plotësoi vetë Jeronim de Rada. Ai na njofton se ka pasë në dorë edhe vepra të tjera, si b.f.j. dy dorëshkrime të helenistëve të përmendun Stanislao Jenò e Luca Tocchi siedhe disa punime filologësh të kohës, që ai muji me njoftë, si p.sh. nga Theophile Stier, Gustav Meyer dhe Dhimitër Camarda. Auktori ynë i nderuem e shpreh vetë, me modesti, se nuk ka qenë fort i përgatitun në gjuhësi dhe në filologji. Megjithatë, këtë mungesë përgatitjeje shkencore, ai e kompensoi me një vullnet të madh dhe me një punë frytdhanëse. Fjalorthi ka 22 faqe me një njëmijë e sa fjalë, botue në dy shtylla: shqip (në dialektin arbëresh) me përkthimin përbrë italisht. Pikërisht këtëj "Fjalorthi" — siç e thamë edhe ma sipër — i ka kushtue, kohët e vona, një artikull Emanuele Giordano.

Tezën pellazgjike Jeronim de Rada e mbroi edhe në punime të tjera. Më 20 shtator 1885 ai botoi artikullin "*Pellazgë dhe Helenë*"<sup>1)</sup>, që asht një studim i ngjeshun ndër gjashtë faqe. "Nga gjuha greke — shkruen auktori — kemi shkrime dhe monumente nja trimijë vjetsh"; "përkundrazi, nga gjuha shqipe, shembulli ma i moçëm, që dimë deri më sot, na erdh katërqind vjet ma parë me Rapsoditë dhe me gjuhën e familjeve, që mërguen në Itali...". "Por në tanësinë e gjuhës shqipe — vazhdon De Rada — ndihet një dishka që asht gati ma e vjetër se koha e monumenteve të gjuhës helenike; madje nëpër këto eci dhe u përshkue kjo". Për të argumentue tezën e vet, merr dhe shqyrton disa emna gjanash: *borë, det, dhe, nëmë* (=nâmë), *dyll, yll, shi*; emna vendesh: *Pelja, Hjima, Teemp, Thesali, Farsalia, Krimea*, etj.; emna hyjnish greke: *Athena, Dhemetra, Afrodite, Urano*, etj. "Këto fjalë — shton De Rada — hynë në gjuhën greke prej popujsh që banuen motit të jetës Greqinë; por nuk i përkasin greqishtes: ato sot gjinden në gjuhën tonë dhe zgjidhen me anë të së folmes sonë". Mandej auktori ven në dukje se Herodoti, një nga ma të vjetrit shkrimtarë grekë, la të shkrueme që në kohë të tij, Greqia ishte e banueme prej dy popujsh, njeni quhej Pellazg = plak dhe tjetri Helen, që zbriti aty ma vonë dhe i shtyni drejt veriut të vendit ata që nuk iu nënshtruen duerlidhun këtëj. Simbas Herodotit, një pjesë tjetër o ndej afër tyne o u përzie me ta. Përsëri, tue iu referue këtëj shkrimtari pellazgët flitshin një gjuhë të ndryshme nga ajo e helenëvevet. Këtë — thotë Herodoti — e pat dëgjue edhe ai vetë. Ai rrëfen se gra helene athinase, të vjedhuna nga pellazgët e Lemnos, ua mësojshin bijvet gjuhën e vet për t'u ndenjë përballë burravet të tyne. Edhe disa nga zotat e Olimpët helen ishin marrë prej kultit të pellazgëvevet. "Kur lexova këto — shkruen De Rada — thashë me vete: Shqiptarët janë pellazgët e Greqisë". Tue vazhdue në këtë mendim, ai shton: "Pellazg nuk qe, pra, emën populli, por shenoi ata që ishin ma përpara se helenët në atë vend", d.m.th. atë popull që ishte ma i moçëm, ma *plak*. Po aty, auktori përpigjet me sqarue edhe vështrimin e emnavet *Arbëresh* = Apiresi, *Epiri* = Arbëri, *Shqiptar* = Qeravni. *κεράυ-veiv* = shkëlzim, që shkëlqen). "Gustav Meyer — thekson De Rada — shkroi para pak kohe<sup>2)</sup> se t'Arbëresht janë një degë e Ilirëvevet". Mbassi polemizon me albanalogun e shquem, tue e kundërshtue këtë tezë, poeti ynë ven në dukje se prindët tanë qenë dikur, ndër kohë të lashta, edhe në Itali

1) *Pelagii ed Elleni*, në "Fiàmuri Arbërit", viti II, nr. 5, fq. 3-8, Cosenza, 20-IX-1885.

2) Në "Nuova Antologia", viti XX, dt. 15 prill 1885. (Simbas De Radës — J. K.)

të poshtëme. Si rrjedhim, simbas tij, me anë të shqipes mund t'u epet do, methania disa hyjnive latine: *Vesta, Elicio, Diana, Pane, Angherona, Dhia-Lari*, etj.

Tue marrë shkas nga një artikull i Thimi Mitkos, që u botue në "Fiāmuri Arbërit", më 20 prill 1886, dhe që bante fjalë mbi disa elemente toponimikë dhe antroponimikë, De Rada, në punimin e vet shqip italisht "Gjurmë trojesh tonë të vjetra, që vazhdojnë me qëndrue ende<sup>1)</sup>, merret me çështjen e prejardhjes dhe të autoktonisë së popullit shqiptar, me përhapjen e fiseve ilire dhe epirote, sidhe me zanafillën e gjuhës shqipe. Aty ka mendime edhe mbi historinë e Shqipnisë dhe mbi folklorin tonë<sup>2)</sup>. Në këtë studim, që fatkeqësisht mbet pa u përfundue së botuemi, për arsye se u mbyll e përkohëshmjia "Fiāmuri Arbërit", bie në sy për të mirë mbështetja tek disa autorë klasikë, si b.f.j. te Straboni, Teopompi, Tukididi, Virgili, etj.

Më 1891, Jeronim de Rada botoi italisht "Pellazgë dhe Shqiptarë", që asht një përpunim i veprës: "Lashtësia e kombit shqiptar dhe afërsia e tij me helënët dhe latinët".

Në vitin 1893, Jeronim de Rada botoi librin: "Konferenca mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe"<sup>3)</sup>. Këto konferenca janë mbajtë në formë leksionesh në shkollën e gjuhës shqipe të Shën Mitrit, gjatë vitit 1892-1893 dhe janë botue italisht në Napoli në një vëllim prej 39 faqesh. Punimi që shtypë ndër fashikuj të posaçëm, të cilët shpërndaheshin nëpër kolonitë arbëreshe. Qëllimi i autorit ishte me krijue një opinion publik rreth çështjes shqiptare, me

1) *Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora*, në "Fiāmuri Arbërit", viti III nr. 5, fq. 1-4, Cosenza, dt. 15-V-1887, viti III, nr. 7. Iq. 5-7, dt. 15-XI-1887.

2) Folkloristi ynë i mirënjohun, Qemal Haxhihasani, në veprën e tij: *Thimi Mitko* (1820-1890), N.Sh.B. "N. Frashëri", Tiranë, 1962, fq. 54-56, megjithëse hedh një hije dyshimi, gabimisht ia ka ngjeshë Thimi Mitkos studimin e Jeronim de Radës: "Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora", botue më 15-V dhe 15-XI-1887 në "Fiāmuri Arbërit". Ja se ç' shkruen Qemal Haxhihasani: "Artikulli me titull *Vestigie delle antiche nostre sedi che durano tra noi* u botua pjesë pjesë në tre numra të revistës "Fiāmuri Arbërit". Pjesa e parë, e cila nënshkruhet me emrin e Th. Mitkos, është një përshkrim krahasues i disa elementeve të përbashkëta, që kanë mbetur këndë dhe andej Adriatikut në fushën e toponomastikës dhe të emrave patronimikë. / . . . Dy pjesët e tjera që epen me të njëjtin titull dhe si vazhdim i pjesës së parë janë anonime. Duke u nisur nga titulli dhe nga paraqitja e tyre si pjesë organike të të njëjtit studim, mund të merrej si autor i tyre Th. Mitko. Por midis pjesës së parë që mban emrin e autorit tonë dhe dy pjesëve të tjera që janë pa emër, ka ndryshime të thella. / . . . Nga mënyra e trajtimit, stili, gjërësia dhe kompetenca e rrahjes së problemeve në dy pjesët e fundit të studimit *Vestigie delle antiche nostre sedi*. . . do të thoshim se ato nuk duhet t'i përkasin autorit tonë; megjithëkëtë nuk mund të përjashkohet fare mundësia e ndikimit të tij, sidomos në problemet folklorike që trajtohen në të". — Që ky studim asht i Jeronim de Radës — e kemi fjalën për pjesën e dytë dhe të tretë — njëjet jo vetëm nga dialekti arbëresh dhe nga leksiku i tij, por edhe nga një shprehje e fundit e poetit të madh arbëresh, e pavjume oroe nga Qemal Haxhihasani. Po e riprodhojmë tekstualisht, me të folmen e tij dhe përkthimin në italisht që i ka bërë për brj vetë De Rada: "Pas që dhiovasa tek Erodoti se Zotërat e Olimpët Ellen e patëtin piasmen te gjintja pelasje, që Ai njohu e gjeti ndër paratë ku ndër mot Strabonit rrijin t'Arbëreshit si pamë; e emërat e atire Zotërave fshenjin fjalë t'Arbëresha mek përcëmonjëmi edhe sot gjëat mbi ciljat ata kinë zotërijë njoha dëjirë se ata Pelasje të vendit, jemi na mberë të huajvet që pasandaj shkuan ndër ne.—Dopo ch'ebbi letto in Erodoto nel 1841 che i Numi dell' Olimpo ellenico ebbero nascimento nella gente pelasga. La quale Ei vide e trovò nelle contrade ove al tempo di Strabone dimoravano gli Albanesi come vedemmo; e poich' ebbi avvisato che i nomi di quelle deità erano parole albanesi con le quali disegniamo anche oggi le parti della natura figurate in quelle deità: conobbi sotto a luce serena che que' Pelasgi, *autoctoni* della Grecia siamo noi di fronte agli stranieri sopravvenuti" (Rev. "Fiāmuri Arbërit". III-7-7, Cosenza, 15-XI-1887). Shprehjen "...mbassi lexova tek Herodoti më 1841, . . .", De Rada e ka thanë edhe ndër nja tri vende tjera, siç e pamë ma sipër, në fillim të këtij punimi.

3) Girolamo de Rada, *Conferenze su l'antichità della lingua albanese e grammatica della medesima*, Napoli, 1893, Tipografia di Francesco Mormile, Largo S. Gaetano, 314, in 8<sup>o</sup> me 39 faqe.

zgjue kureshtjen dhe interesin shkencor të dijetarëve të ndryshëm në lidhje me studimin e prejardhjes së popullit tonë dhe të gjuhës shqipe; njëkohësisht me mbajtje gjallë ndjenjën e dashunisë për Shqipëri tek bashkatdhetarët e vet.

Vepra hapet me një citat të gjuhëtarit të shquem Max Müller: "Gjuha u quejt tokë e shenjtë, pse në të shkon e vendoset mendimi". Vëllimi përmban një hymje, katër konferenca dhe shenime përkatëse. Janë tema të punueme me zjarrin e pashuem të De Radës, plak e lodhë nga 78 vjetët dhe nga vuetjtet shpirtënore, familjare, ekonomike, por punëtor i palodhun. Këto biseda i përshkon ndjenja e ngrohtë dhe e fuqishme e apostullit të shqiptarizmes, dashunia e pakufi për gjuhën shqipe, për popullin shqiptar dhe për atdheun e robnuem. Janë fjalë të thanuna plot shpirt, të daluna nga një zemër e zhuritun, e përvëlueme, kahë shef bashkatdhetarët e vet në mjerimin shekullor osman. Tue u mbështetë tek lashtësia e gjuhës shqipe dhe tek autoktoniteti i njerëzvet, që e flasin këtë, ky vigan i kulturës dhe i mendimit kombëtar, kërkon nga bota e qytetnueme që t'i japë popullit shqiptar të drejtat që i takojnë: lirinë dhe pavarësinë e dëshërueme, për të cilën shqiptarët luftuen me vetmohim për qinda vjet dhe e vaditën me gjakun e tyne tokën arbënore<sup>1)</sup>.

Me një renditje të re, me një ndamje të re lande dhe me argumente të reja auktori pohon dhe përforcon parimet e tij rreth prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve. Në fillim thekson gjendjen në të cilën gjinden kombi, gjuha shqipe dhe studimet përkatëse. Tregon shkurt jetën me brenge, që përshkuen arbëreshët ndër vise të hueja. Mbassi ka vù në dukje lashtësinë e gjuhës shqipe tue u shtÿ deri ndër kohënat e historisë ma të vjetër, De Rada flet mbi lëvizjen e madhe për rilindjen kombëtare, që po bëhej nga kolonitë shqiptare të Turqisë, Rumanisë, Greqisë dhe Italisë. Shenon randësinë e madhe që kanë punimet shkencore për studimin e gjuhës amtare. Kundërshton albanalogun e shquem Gustav Meyer, që i kishte nxjerrë shqiptarët nga ilirët dhe mbron tezën e vet të njoftun se shqiptarët rrjedhin nga pellazgët.

Auktori asht i bindun në këtë prejardhje dhe përpigjet ta mbrojë mendimin e tij me dy argumenta: me kangët tradicionale ose me rapsditë dhe me afërsinë e shqiptarëve me trakët, trojanët dhe romakët. Simbas tij, këtu ndihmojnë si dëshmi emnat historikë dhe mitologjikë grekë e latinë, të cilët gjejnë shpjegimin e tyne vetëm në shqipet. Shqiptarët janë pellazgë, ripohon De Rada, për arësye se emnat e hyjnivet të grekëve interpretohen, gjoja, me anën e gjuhës së sotme shqipe. Po kështu edhe vetë fjala "pellazg" asht shqipe. Përsa i takon traditës, dihet se shkrimtarët grekë patën përhapë lajmin se, gjithë krahina, që shtrihet nga veriu i Greqisë deri në Adriatik, ishte e banueme, në kohë të moqme prej një populli të vetëm, që ishin maqedonë dhe maqedonët — shton De Rada — nuk ishin tjetër vegse shqiptarë. Edhe zakonet e shqiptarëve të sotëm përputhen me ato të maqedonëve me prejardhje pellazgjike.

Në vitin 1894, Jeronim de Rada botoi italisht, në Koriliano Kalabro, librin: "*Karakteret dhe gramatika e gjuhës shqipe*"<sup>2)</sup>.

Vëllimi hapet me fonetikën e shqipes, së cilës hartuesi i ka kushtue njëzet faqe. "Gjuha shqipe — shkruen ai — asht e pasun në fleksion, por ndryshon prej greqishtes dhe latinishtes". De Rada ngrihet kundër grekëve, të cilët, për qëllime të këqia, e qitshin shqipen me prejardhje nga gjuha e tyne.

1) Jup Kastrati, *Konferenca mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe*, vepër e Jeronim de Radës, artikull në gaz. "Luftëtari", nr. 55 (1711), fq. 3-4, Tiranë, 12. VII. 1962.

2) Girolamo de Rada, *Caratteri e grammatica della lingua albanese*, Corigliano Calabro, 1894, Stabilimento Tipo-Litografico del Popolano, in 80 me 100 faqe

Fillimin e veprës auktori ia ka kushtue shkrimit të vjetër të gjuhës sonë. Se çfarë alfabeti përdorën shqiptarët e lashtë, kjo nuk dihet — shenon auktori —. Por, tue u mbështetë te Hahn, ai përmend alfabetin me 52 shkronja, të cilin albanologu i mirënjoftun e pat marrë për pellazgjik. Mandej përmend librat shqip, me shkronja latine, botue nga Propaganda Fide, citon Fjalorin e Bardhit, veprën e Jul Varibobës, "Gjella e Shën Mërisë Virgjër". Mjerisht, këtu, ai bie në një gabim. Simbas De Radës, librat e parë, të botuam në shqipet, i përkasim, gjoja, qindvjetit të XVIII (!). Si shembull ai sjell "Fjalorin" e Bardhit, të cilin, me sa duket, s'do ta ketë pa; pse, po ta kishte pasë në dorë, do ta vrente që nuk i takon shek. XVIII, por vitit 1635; pra shek. XVII. Nga ana tjetër, veprat e Budit nuk i ka njoftë fare, për sa kohë nuk i përmend dhe për deri sa shprehet që botimet e para shqipe janë të qindvjetit të tetëmbëdhjetë.

Gramatologu ynë shenon se alfabetet e veprave të shkrimtarëve të vjetër të letërsisë shqipe, botue nga Propaganda Fide, nuk arrijnë me i paraqitë të gjithë tingujt e gjuhës sonë. Ma poshtë ai përmend mënyrën e shkrimit të shkrimtarëve arbëreshë, të cilët patën për bazë alfabetin latin, plotësue me disa shkronja greke. Dijetarët Hahn e Stier shtinë në përdorim alfabetin grek, por me disa shkronja latine. Në mënyrë të veçantë ai ndalohej tek alfabeti i Camarda-s dhe tek ai që përdori vetë De Rada. Auktorit tanë iu duk si ma i përshtatshëm alfabeti latin, për arsye se njëjef nga kolonia shqiptare e atjeshme; por mungesën e tij ai e plotësoi me disa shkronja greke dhe me pak shenja të veçanta. Kështu ai besonte se shqipja do të pasqyrohej besnikërisht, tue i dhanë një vlerë të vetme çdo shkronje, qoftë kjo e thjeshtë a e përzieme. Por, përsa u përket tonave, theksat klasikë ishin të pamjaftueshëm. Hymja e veprës mbyllet me fjalët e birit të tij, Zefit, i cili në "Gramatikën shqipe" të vitit 1871, thotë se alfabeti i përbashkët për të gjithë shqiptarët do të vinte disa vjetë ma vonë, kur të dilshin në pah vepra shqipe me vlerë dhe kur të krijohet një shtyp i mjaftë në këtë gjuhë.

Mbas këtij vështrimi të shpejtë, me karakter pak a shumë historik, De Rada hidhet në kapitullin e parë të "Gramatikës" së tij, në të cilën vëzhgon tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të shqipes. Aty polemizon me albanologun e shquem Gustav Meyer, rreth çështjes së ë-së atone. Pjesa tjetër e librit (fq. 21-99) merret me morfologjinë. Kjo zen pothuajse tri të katërtat e vëllimit.

Tue e shikue me "Gramatikën" e vitit 1871, kjo e 1894-ës ka mjaft ndryshime me të parën. Në të vërtetë kjo asht një vepër tjetër, sadoqë asht mbështetë tek ajo. Në krahasim me të përparëshmen, kjo na paraqitet ma e thjeshtë, ma metodike dhe ma praktike. Auktori asht përpjekë që ta lehtësojë anën shkencore, megjithatë, edhe këtu, nuk mungojnë ndërhyrjet gjuhësore, filologjike dhe diskutimet ditunore mbi një çështje a një tjetër. Herë mbas here përmenden Da Lecce, Xylander, Hahn, Dozon, Benloew, G. Meyer, etj. E bajnë të qartë dhe të përmbledhtë veprën — pasqyrat (paradigmat) përmbledhëse, përdorë nga hartuesi i librit pothuajse për çdo temë. Një vlerë të veçantë kanë edhe vërejtjet përkatëse o në fund të kapitullit ose në fund të faqes.

Nga data 1 deri më 12 tetor 1899 u mbajt në Romë Kongresi XII Ndërkombëtar i Orientalistëve. Shkrimtari i mirënjoftun dhe atdhetari i madh arbëresh, Jeronim de Rada, qe ftue të mernte pjesë si delegat. Kongresi në sesionin e parë kishte si rend dite: "Gjuhësia e përgjithëshme indoeuropiane dhe gjuhët e vjetra italiane". De Rada mbajti ligjeratën "Karakteret e gjuhës shqipe dhe monumentet e saj në kohën prehistorike", botue në Catanzaro më

1899<sup>1</sup>). Në mbrendi nuk ndryshon shumë prej librit "*Konferenca mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe*" që folëm ma sipër. Broshura ka në fillim një njoftim të shkurtër rreth katedrës së gjuhës shqipe, themelue në kolegjin e Shën Adrianit dhe transferue, ma vonë, në Shën Mitër. Mandej autori ven në dukje origjinalitetin e gjuhës shqipe, qëndrueshmërinë e saj ndaj formave të vjetra, thekson veçantinë e saj njërrrokëshe. Emnat lakohen në trajtë të dyfishtë, në të shqueme dhe në të pashqueme; foljet, sikurse në greqisht, ndahen në tri klasa: veprore, mesore dhe pësore. Ato kanë pesë mënyrë: dëftore, dëshirore, lidhore, paskajore, urdhënore; me dy zgjedhime, nga të cilat njëni me zgjedhim të fortë. Emnat kanë edhe gjiminë asnjane. Në shqip një shtatë zanore dhe tridheshatë bashkëtingëllore. Përsërit ato që ka shprehë ndër botimet e maparëshme, që emnat e hyjnive pagane shpjegohen me anë të shqipes. Në këtë pikë përmend një seri shembujsh, që do të përbajshin provën e arësytimit të tij. E mbyll punimin e vet me pohimin e guxueshëm të rilindasvet që Aleksandri i Madh, Pirrua, Diokleciani dhe Juliani ishin shqiptarë.

Veprat gjuhësore të botueme nga Jeronim de Rada, gjatë një periudhe pesëdhjetëvjeçare, janë pra: "*Hyjnitë pellazgjike*" (1840-1845) "*Lashtësia e kombit shqiptar dhe afërsia e tij me helenët dhe latinët*" (1864), "*Gramatikë e gjuhës shqipe*" (1871), "*Fjalori i Rapsodivet*" (1885), "*Pellazgë dhe helenë*" (1885), "*Gjurmë trojesh tona të vjetra që vazhdojnë me qëndrue ende*" (1886), "*Pellazgë dhe shqiptarë*" (1891), "*Konferenca mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe*" (1893), "*Karakteret dhe gramatika e gjuhës shqipe*" (1894).

Në veprimtarinë gjuhësore të De Radës duhet përfshi edhe puna e madhe që ai bani për alfabetin e gjuhës shqipe. Para tetë vjetësh na botuem disa shenime mbi alfabetin e tij<sup>2</sup>). Kohët e fundit, Giuseppe Gradilone ka shkruar një artikull të veçantë për këtë çështje<sup>3</sup>).

Në historinë e alfabetit të gjuhës shqipe, përpjekja e Jeronim de Radës për një alfabet tonin të përbashkët ze një vend me randësi. Që në vitin 1836 ai shkruente: "Tue mendue me caktue një alfabet për gjuhën e këtyne kangëve (=të Milosaos — J.K.) u mbështeta në shkrimin italian, sepse ishin në mes të Italisë vendet ndër të cilat unë dojshem me e bā të njoftun këtë poezi. Por tue dijtë se shqipja, ndoshta shumë e vjetër mes gjuhëve të Europës dhe e lindun gati njëkohësisht me ndjenjat, kish ma tepër se italishtja elemente të gjithënduershëm, e drejtova vemendjen nga gjuha e Greqisë, që, siç beson Malte-Brun dhe bashkëkohësi im mendjendrituri Schirò, e pat burimin në tonën. E, tue qenë se shkronjat *c, d, g, j, z*, të cilat duhen në fjalët shqipe nuk kishin shenja në alfabetin grek, shpresojshem që, tue analize shkrimet e vjetra të kësaj gjuhe, do të kishem gjetë tinguj mjaft të randë të shenjave të sipërpërmendun në hartimin e shkronjave përgjegjëse të buta *κ, δ, γ, χ, ξ*, me spirituese dhe të tjera shenja zanoresh o dyzanoresh, theksimin e të cilave nuk e njoftin mirë. Kjo ide që me zbulue me tingujt e së folmes së Epirit harmoninë e vërtetë të gjuhës helenike qe lanë mbas dore nga dyshimet mbi qenien e një harmonie këso dore, dyshime të shtueme nga shpirti im i padurueshëm e nga një gjëndje krejt e shqetësueme. Unë prandaj hartova

1) Girolamo de Rada, *Caratteri della lingua albanese e suoi monumenti preistorici*, Cantanzaro, 1899, Officina Tipografica di Giuseppe Calò, 45, Via XX Settembre, faqe 13, dim. 15, ×21,5.

2) Jup Kastrati, *Shenime mbi alfabetin e De Radës*, në librin: Jeronim de Rada *Poezi shqipe të shekullit të XV. Kangë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës*, Tiranë, 1956, N. Sh.B., fq. 106-113.

3) Giuseppe Gradilone, *Studi di letteratura albanese*. Roma, 1960, Urbinati Editore, fq. 108.

një të tretë me shenja italiane dhe një si shtojcë me shkronja greke, të cilin e kam përdorë vazhdimisht si diçka të plotë dhe që nuk sjell të meta. Unë po e vë në krye të kangëvet, me qëllim që leximi i vetë atyne t'u vijë ma i lehtë italogrekëvet<sup>1)</sup>.

Siç shifet, De Rada aso kohe, zgjidhjen e problemit të alfabetit të gjuhës shqipe e gjendte në karakteret e shkronjave italiane me një shtesë shenjash greke. Por, tue mos qenë i kënaqun, më 1847, në botimin e dytë të "Milo-saos", provoi një mënyrë tjetër, që thotë se e ka nxjerrë prej "Gramatikës shqipe" të Camillo de Rada<sup>2)</sup>.

Në vitin 1866, kur De Rada botoi "Rapsodi të një poemi shqiptar" Niko-lla Jenò de ' Coronei, në hymje të veprës, mbassi ban një syzim të shkurtë të historisë së alfabetit shqip, tue përmendë Bardhin, Varibobën dhe ndonjë tjetër, e mbyll parathanien e vet me këto fjalë: "Jeronim de Rada, shumë i ditun në gjuhën shqipe, embledhësi i parë e, mund të thom i vetmi i këtyne kangëve, asht tue u marrë me caktimin e alfabetit shqip mbrenda skajeve të parimeve gjuhësore të pranueme prej të gjithëve". Në fund të faqes 16 ka dhetë rreshta shenime mbi "alfabetin shqip<sup>3)</sup>". Baza e këtij alfabeti asht ai latin, por me pesë shkronja të huajtura nga alfabeti grek:  $\upsilon$ ,  $\chi$ ,  $\zeta$ ,  $\delta$ ,  $\Theta$ , përkatësisht për : *ë, hj, z, dh, th*.

Më 1871, në "Gramatikën shqipe" të Zefit, tue folë mbi alfabetin De Rada shkruen edhe këto: "Gjuha shqipe ka ma shumë tinguj se latinishtja dhe se vetë greqishtja; siç e shqiptojmë na sot tue e lexue. E tanë shprehja e gjuhës shqipe mund t'i gjejë shenjat, për të cilat ka nevojë, në bashkimin e dy alfabeteve greke dhe latine; e abejeja ma e qartë e tij do të ishte, ndosh-ta, sikur t'u gërshetojshin lirisht shkronjat greke e latine. Por mbassi Europa perëndimore ka pranue përgjithësisht alfabetin latin, . . . e pël-qejmë këtë alfabet, por simbas nevojës, tue përdorë për shprehjet tona pesë shkronja greke e pak shenja të tjera tashma të njoftuna nga albanologët".

Më 1883, kur filloi me botue "Fiëmuri Arbërit", që në krye të numrit të parë, De Rada, nën titullin "Alfabeti shqip", theksonte se "simbas këshil-lit të filologëve të ditun, tue lanë më nj'anë disa shkronja greke, përdorë prej nesh ma përpara dhe, tue pranue pak shenja artificiale, i jemi përmbajtë ma tepër alfabetit italik dhe përdorimit të tij; me qëllim, sidomos, për të pasqyrue krejt pjesën e fonetikës së folun ndër kolonitë"<sup>4)</sup>. Këtë e përsëriti mbas tri vjetësh, më 15 tetor 1886, po në këtë të përkohëshme<sup>5)</sup>.

Më 1894, në "Karakteret dhe gramatika e gjuhës shqipe", De Rada e sistemoi në mënyrë definitive alfabetin e tij, tue i dhanë një trajtë ma të plotë dhe ma të arësytueme; përsëri mbi bazën e alfabetit latin, por me katër shkronja greke:  $\chi$ ,  $\delta$ ,  $\Theta$ ,  $\xi$ , përkatësisht me të sotmet: *hj, dh, th, z*. Më 1897 ai botoi "Abetari i gjuhës shqipe", pranue nga Kongresi kombëtar i mbledhura në Corigliano Calabro në tetor të vitit 1895<sup>6)</sup>.

1) Girolamo de Rada, *Poesie albanesi del secolo XV. Canti di Milosao figlio del Despota di Scutari*, Napoli, 1836, Da' Tipi del Guttemberg. Avvertimento, fq. XI.

2) Girolamo de Rada, *Poesie albanesi*, prima parte, Napoli, Stamperia del Fibreno; 1847, fq. 7-8: "Dalla Grammatica albanese di Camillo de Rada.

3) Girolamo de Rada, *Rapsodie d'un poema albanese*, Firenze, 1866, fq. 13. — Alfa-beto albanese, fq. 16.

4) *Alfabeto albanese* në rev. "Fiëmuri Arbërit", viti I, nr. 1, fq. 1, Corigliano Calabro, 20 korrik 1883.

5) *Alfabeto albanese*, id. ibid., III, 1,1, Cosenza, 15.X.1886.

6) *Abecedario della lingua albanese* approvato ed adottato dal Congresso nazionale unito in Corigliano Calabro nell'ottobre del 1895, edito a spese del Cav. Uff. Anselmo nobile Lo-rechio, vice presidente della Società albanese. Corigliano Calabro, Stabilimento tipo-lito-grafico del "Popolano", 1896, në 80 me 8 faqe.



por në shkrimet e tij nuk zihen me gojë Skylaksi, Hekateu, Aristoteli, Ptolemeu, etj., të cilët, siç dihet, kanë mjaft të dhana për ilirët.

Nga ana tjetër, me sa duket nga burimet që ka përdorë, De Rada nuk qe i azhurnuem me kërkesat e albanologjisë, veçanërisht me rezultatet e arrituna në fund të shek. XIX. Ai nuk qe në kontakt as me zhvillimin e gjuhësisë krahasimtare të gjysmës së dytë të qindvetit të kaluem. Sadoqë pat lidhje me dijetarë të ndryshëm, siç e vërteton epistulari i tij i pasun, që ruhet sot në Arkivin e Shtetit, prapë se prapë ai nuk kishte një bibliotekë të pasun me vepra shkencore të kohës. Së fundi, ndenja e tij, vazhdimisht, në fshat, larg një qendre intelektuale, ku të kishte një lëvizje mendore për të qenë, sikur e mbajti të izoluem nga sukseset e gjuhësisë dhe të albanologjisë. Pamvarësisht, nëse u ushqye në mënyrë sporadike me vepra dijetarësh së huaj, që i dërgoheshin si çkëmbim të librave të tij, prapë se prapë De Rada, me sa na rezulton, mbeti larg dijes së gjuhësisë. Tjetër ishte pasioni që ndrynte në vetëvehte, dhe të tjera ishin mundësitë reale që ai kishte për doresh. Mandej ai pati guximin të merrej me etimologji, pa qenë i përgatitun që ma përpara me këtë dije. Ai veproi ma fort si diletant se sa si specialist i profesionit. Profili i tij nuk qe gjuhësia. Për ma se një gjysëm shekulli u suell e u pshtuell, herë mbas here, rreth teorisë pellazgjike, pa qenë në gjendje me bā një hap përpara që nga viti 1840 e deri më 1899. Për ma tepër, kemi përshtypjen se, në përpunimin e veprave, përsëriti vetëvehten. Kurrë ndonjëherë nuk iu referue autoriteteve të albanistikës të periudhës së tij, si Hahn, Bopp, Miklosich, Meyer, Pedersen, megjithëse me ndonjenin sish pat edhe letërkëmbim; bile, me Meyer-in u ndesh dy herë në polemikë, por me humbje. De Rada njofti, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, Xylander, Stier, Schuchardt por fatkeqësisht nuk i çfrytëzoi. Ai citon, në të rrallë, Pouqueville, Humboldt, Max Müller, Bucholtz, por pa përfitim. Poeti ynë i shquem pat një simpati të veçantë për L. Benloew, A. Dozon dhe L. Podhorszky, të cilët, siç dihet, nuk kanë ndonjë vlerë specifike në studimet albanologjike. Nga dijetarët arbëreshë, ai u mbështet ndonjëherë tek A. Masci, E. Bidëra, D. Mauro, T. Pace, D. Camarda, me qëllim që të mbronte tezën e vet.

Sidoqoftë, edhe në fushën gjuhësore, veçanërisht në veprat gramatikore, De Rada dha një kontribut të vlefshëm. Puna e tij në këtë drejtim qe mjaft frytdhanëse. Ajo duhet çmue dhe vlerësue, sidomos, si ndihmëse për njofjen e dialektit arbëresh në forma fonetike e morfologjike dhe në leksik. Vepra e tij gjuhësore do të mbetet në historinë e albanologjisë si një përpjekje fisnike e një shqiptari të madh, i cili, me gjithë mungesën e përgatitjes rigorozë linguistike, me gjithë mungesën e anës materiale, me gjithë vuetjet e mëdha shpirtënore dhe kushtet e disfavorëshme, arriti me zgjue kureshtjen e botës shkencore të dijetarëve të kohës.

## R é s u m é

## L'OEUVRE LINGUISTIQUE DE JERONIM DE RADA

En jetant un regard d'ensemble à la création linguistique de Jeronim de Rada, Kastrati fait remarquer que malgré ses grands mérites, il lui a manqué une méthode strictement scientifique dans des disciplines telles que la phonétique, la morphologie, l'étymologie, la lexicographie, qu'il cultiva pendant 65 ans (1836-1899). Au fondement de son oeuvre linguistique réside une thèse sujette à discussions celle de l'origine pélasgique. Dans la plupart des cas les interprétations de l'auteur sont insuffisantes. De Rada s'est occupé d'une période très lointaine, aussi antique que même l'histoire ne peut que difficilement se prononcer à ce sujet. L'époque des Pélasques est lacunaire aussi point de vue de la documentation, elle s'enfonce dans la brume de âges et s'enveloppe plus de légende que d'histoire. L'auteur a travaillé plutôt avec le sentiment qu'avec la logique.

Jeronim de Rada a eu plusieurs avantages qui l'ont favorisé dans ses études à caractère historique et linguistique. Il connaissait les Arbëresh et leur dialecte, qui gardait des reliques des siècles XV-XVI, mais il ne connaissait pas la langue vivante de sa mère-patrie. Il n'est jamais venu en Albanie pour prendre contact avec les parlers de l'albanais de son temps et suivre de près la langue albanaise dans sa mère-patrie.

De Rada a eu une culture classique. Il possédait d'amples connaissances sur le grec et le latin, cependant il n'a pas fait une moisson régulière des historographes, des géographes et des écrivains grecs et latins. S'il a consulté Homère, Hésiode, Hérodote, Thucydide, Plutarque, Euripide, Virgile, Pline, Catulle, Ovide, Strabon, César, Théopompe, etc., il lui manquent des références sur Skylax, Hécatee, Aristotele, Ptolémée, et autres, qui offrent d'importantes données sur les Illyriens.

D'autre part, selon toute vraisemblance, de Rada ne fut pas dûment ajourné notamment avec les résultats obtenus dans le domaine de l'albanologie à la fin du XIX<sup>e</sup> s. Il n'a pas été en contact avec le développement de la linguistique comparée de la deuxième moitié du siècle dernier.

Toutefois, aussi dans le domaine linguistique, notamment dans ses ouvrages sur la grammaire, de Rada a donné une contribution précieuse. Son activité dans ces domaines a été fertile. Elle doit être appréciée notamment pour la connaissance du dialecte arbëresh dans ses formes phonétiques et morphologiques aussi bien que dans son lexique. Jeronim de Rada a accordé une attention particulière aux questions de l'origine de l'albanais et des Albanais. Et cela il l'a suivi avec le plus grand zèle pendant toute son existence.

On pourrait opiner que les froides disciplines linguistiques ne concordent pas avec sa nature poétique et ses inspirations. En fait, il avait plutôt l'étoffe de l'artiste que celle de l'homme de science. Néanmoins, malgré ses divagations, son oeuvre linguistique restera dans l'histoire de l'albanologie comme une tentative noble d'un grand Albanais qui parvint à ressusciter l'attention du monde scientifique et des savants de son temps sur notre pays.